VENDIM
Nr.44, datë 15.6.2011

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE SHTESË NGA BANKA TIRANA SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a", nenit 43, shkronja "e" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" të ndryshuar, të nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1, shkronja "ç", të nenit 54, pika 2, shkronjat "d", "dh/iii,v,vi,vii", "e"/i,ii" dhe "ë" të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka Tirana sh.a. të veprimtarive financiare shtesë, si më poshtë:

a) Ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve;

b) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, të:

i) produkteve derivative (instrumente derivative), duke përfshirë, midis të tjerave, kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me opsione (options);

ii) letrave me vlerë të transferueshme;

iii) instrumenteve të tjera të negociueshme dhe aktive financiare, duke përfshirë veprimet me arin.

c) Pjesëmarrjen në emetimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, duke përfshirë nënshkrimin dhe vendosjen si agjent (si publik, ashtu edhe privat) dhe kryerjen e shërbimeve lidhur me këto emetime.

d) Ndërmjetësimin për transaksionet monetare të mëposhtme:

i) administrimin e aktiveve të tilla, si administrimi i parave dhe i portofolit, administrimi i fondeve,

ii) shërbimin për kompensimin dhe shlyerjen e pagesave të aktiveve financiare, duke përfshirë letrat me vlerë, produktet derivative dhe instrumente të tjera të negociueshme.

e) Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara më sipër.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës të Bankës Tirana sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani